

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE



Edukimi, Informimi dhe Ndërgjegjësimi i Zgjedhësve me Aftësi të Kufizuara

ZGJEDHJET PËR KUVEND **11 MAJ 2025**



ZGJEDHJE
PËR KUVEND





TË GJITHË VOTOJMË

AFTËSIA E KUFIZUAR NUK
TË PENGON TË VOTOSH





PËRMBLEDHJE

Programi për edukimin e zgjedhësve me aftësi të kufizuar (PAK) për Zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë 2025, përcakton qëllimin dhe objektivat kryesore që duhet të realizohen për edukimin, informimin dhe ndërgjegjësimin e kësaj kategorie zgjedhësish përgjatë periudhës zgjedhore.

Hartimi këtij dokumenti ka për qëllim gjithëpërfshirjen dhe aksesueshmërinë për të votuar .

Ky program përcakton hapat konkretë që do të ndërmerren në realizimin e objektivave tona.

Zbatimi i programeve të ndryshme për edukimin, informimin dhe ndërgjegjësimin e zgjedhësve, në një periudhë të përcaktuar kohe është një proces kompleks, suksesi i të cilit ndërvaret edhe nga kontributi i aktorëve të tjerë që mund të bashkëveprojnë në fushën e aftësisë së kufizuar.

Ky program është përpiluar me qëllim ofrimin e kushteve lehtësuese për të votuar për personat me aftësi të kufizuar dhe rritjen e pjesëmarrjes së tyre në zgjedhje. Për më tepër, ky program ofron informacion të detajuar mbi zbatimin e objektivave të përshtatura për personat me aftësi të kufizuara. Fushata e edukimit dhe informimit që përdoret për zgjedhësit do të këtë të përshtatura marrjen e informacionit zgjedhor për personat me aftësi të kufizuar, si moduli online për personat që kanë vështirësi në shikim apo përshtatjen në gjuhën e shenjave për personat që nuk dëgjojnë, tashmë pjesë e KQZ.

Programi për edukimin e zgjedhësve me aftësi të kufizuar për zgjedhjet për deputetët e Kuvendit të Shqipërisë, synon ndërgjegjësimin për pjesëmarrje në votime dhe informimin e zgjedhësve të kësaj kategorie mbi të gjithë procesin zgjedhor.



KQZShqiperi



KQZShqiperi



KQZShqiperi



KQZShqiperi



KQZShqiperi



kqz.gov.al

QËLLIMI

Programi për edukimin e zgjedhësve me aftësi të kufizuar (PAK), për Zgjedhjet për Kuvend 2025, ka për qëllim promovimin e standarteve për zgjedhjeve të lira dhe të ndershme, gjithëpërfshirjen e të gjithë zgjedhësve, pavarësisht vështirësive që ata kanë për të votuar, si dhe mirëinformimin dhe ndërgjegjësimin e zgjedhësve me aftësi të kufizuar. Një fushatë e veçantë dedikuar personave me aftësi të kufizuar, duke përdorur mjetet e duhura dedikuar këtij target-grupi.

Realizimi i të drejtave të njeriut, posaçërisht i personave me aftësi të kufizuara përbëjnë rëndësinë për zhvillimin dhe mbarëvajtjen e një shoqërie. Realizimi i çdo të drejte për çdo individ, në këtë rast i të drejtës për të votuar krijon mundësi të barabarta që çdo njeri të ketë qasjen e duhur në shoqëri.

Në mënyrë specifike programi ka si qëllim të informojë zgjedhësit për parandalimin e veprave penale; të informojë dhe edukojë zgjedhësit për datën e zgjedhjeve duke i orientuar ata në lidhje me procesin e verifikimit të emrit në listën e zgjedhësve dhe qendrën e votimit ku ai voton; ndërgjegjësimi dhe edukimi i personave me aftësi të kufizuar duke promovuar rëndësinë e procesit të votimit dhe duke i përfshirë ato në spotet që do transmetohen për fushatën e edukimit dhe informimit të zgjedhësve për zgjedhjet 2025, të informojë dhe edukojë zgjedhësit mbi procedurën e votimit dhe identifikimit elektronik; të informojë dhe edukojë zgjedhësit mbi plotësimin korrekt të fletës së votimit.


Mjetet që do të përdoren për të arritur qëllimin dhe objektivat:




Takime me
zgjedhësit PAK




Spote TV



Spote Radio



Media Sociale




Postera në QV



Shablloni
Braille



KQZ app



KQZ Web




Objektivat kryesore të programit:

- 1** | Informimi dhe sensibilizimi i personave me aftësi të kufizuar për të rritur pjesëmarrjen e tyre në zgjedhje, aksesueshmëria
- 2** | Informimi dhe edukimi i zgjedhësve mbi listën e zgjedhësve dhe hapat që duhet të ndjekin për çdo parregullsi.
- 3** | Informimi për mekanizmat e raportimit, në rast se ata ndeshen me parregullsi, apo vërejnë se po i mohohet e drejta për të votuar, apo kushtet e tyre janë të papërshtatshme.
- 4** | Informimi i personave me vështirësi në shikim dhe sigurimi i burimeve edukative në formate të ndryshme për të adresuar nevojat e tyre specifike.
- 5** | Informimi i personave me vështirësi në shikim dhe sigurimi i burimeve edukative në formate të ndryshme për të adresuar nevojat e tyre specifike.

Audienca e synuar:

Të gjithë zgjedhësit PAK me të drejtë vote që kanë mbushur moshën 18 vjeç.



1

Informimi dhe sensibilizimi i personave me aftësi të kufizuar për të rritur pjesëmarrjen e tyre në zgjedhje, aksesueshmëria.

• Grupi ku adresohet: Zgjedhësit me aftësi të kufizuar.

Ky objektivi ka për qëllim informimin dhe ndërgjegjësimin e zgjedhësve me aftësi të kufizuar, si dhe institucioneve përgjegjëse, për krijimin e lehtësirave dhe kushteve për të votuar për personat me aftësi të kufizuar. Aksesimi në marrjen e informacionit zgjedhor dhe krijimi i lehtësirave për të votuar si një domosdoshmëri për këtë grup zgjedhësish, në formatet që i përshtaten këtij target grupi.

• Mjetet e komunikimit



Media sociale. (Do të postohen në këto rrjete mesazhe informuese dhe sensibilizuese me tekst, video, audio, etj. mbi kushtet e krijuara nga Institucioni dhe të gjithë aktorët e përfshirë në procesin zgjedhor, për këtë target grup).



Takime me zgjedhësit (Do të zhvillohen takime me personat me aftësi të kufizuar të cilët do të informohen mbi kushtet e krijuara nga Institucioni dhe të gjithë aktorët e përfshirë në procesin zgjedhor.)



App KQZ (Nëpërmjet aplikacionit mund të gjendet sesioni "edukimi zgjedhor" ku do të merrin informacion mbi të gjitha hapat e procesit.)



Web KQZ (Në website e KQZ do të publikohet i gjithë informacioni mbi të gjithë hapat e procesit.)



Spote televizive (Do të transmetohet spot sensibilizues mbi aksesueshmërinë dhe thirrje për pjesëmarrje)



Postera në Qendër Votimi (Do të vendosen postera sensibilizues për personat me aftësi të kufizuar në çdo qendër votimi.)

• Periudha e zhvillimit të kësaj fushate: Janar 2025 deri ditën e zgjedhjeve



KQZShqiperi



KQZShqiperi



KQZShqiperi




KQZShqiperi



KQZShqiperi



kqz.gov.al



2

Informimi dhe edukimi i zgjedhësve mbi listën e zgjedhësve dhe hapat që duhet të ndjekin për çdo parregullsi.

- **Grupi ku adresohet:** Zgjedhësit me aftësi të kufizuar.

Ky objektivi ka për qëllim të informojë zgjedhësit mbi hapat që ata duhet të ndjekin nga momenti i shpalljes së listës paraprake të zgjedhësve deri në ditën e votimit. Nëse zgjedhësit kanë pasaktësi në listë të emrit apo vendbanimit, i jepet gjithë informacioni me hapat që ata duhet të ndjekin për ti ndryshuar/rregulluar ato. Gjithashtu informohen se ku duhet të drejtohen si dhe mjetet e ndryshme të komunikimit ku ata mund të gjejnë gjithë informacionin mbi procesin zgjedhor.

- **Mjetet e komunikimit**



Media sociale (Do të postohen në këto rrjete mesazhe informuese dhe sensibilizuese me tekst, video, audio, etj mbi listën e zgjedhësve dhe qendrën e votimit)



Takime me zgjedhësit (Do të zhvillohen takime me këtë target grup ku do të informohen se ku mund të gjejnë emrin e tyre në listën e zgjedhësve dhe qendrën e votimit, ku gjithashtu do të nisët materiali dhe tek organizatat që mbrojnë interesat e personave me aftësi të kufizuar me qëllim shpërndarjen e informacionit edhe në organizatat e tjera në rrjet në qytete të ndryshme të vendit.)



App KQZ (Nëpërmjet aplikacionit mund të gjendet qendra e votimit nga çdo zgjedhës nëpërmjet rubrikës "Ku votoj".)



Web KQZ (Në website e kqz-së do të publikohet i gjithë informacioni mbi listën e zgjedhësve dhe nëpërmjet ëeb-it mund të gjendet qendra e votimit nga çdo zgjedhës.)



Spote televizive (Do të transmetohet spot televiziv në televizionet kombëtare dhe lokale mbi listën e zgjedhësve dhe se për çdo pasaktësi që mund të ndeshin, ku do të drejtohen për ti rregulluar ato, në gjuhën e shenjave, për personat që nuk flasin dhe nuk dëgjojnë.)



Spote radiofonike (Do të transmetohet spot mbi listën e zgjedhësve, për çdo pasaktësi që mund të ndeshin dhe se ku do të drejtohen për ti rregulluar ato në radiot më të ndjekura.)

- **Periudha e zhvillimit të kësaj fushate:** Nga momenti i shpalljes së listave të zgjedhësve deri ditën e zgjedhjeve



KQZShqiperi



KQZShqiperi



KQZShqiperi



KQZShqiperi



KQZShqiperi



kqz.gov.al



3 Informimi për mekanizmat e raportimit, në rast se ata ndeshen me parregullsi, apo vërejnë se po i mohohet e drejta për të votuar, apo kushtet e tyre janë të papërshtatshme.

- **Grupi ku adresohet:** Zgjedhësit me aftësi të kufizuar.

Ky objektivi ka për qëllim informimin dhe ndërgjegjësimin e zgjedhësve me aftësi të kufizuar, për mekanizmat e denoncimeve në rast se ata ndeshen me parregullsi. Informacioni për këtë objektivi do të jetë i përshtatshëm për zgjedhësit me aftësi të kufizuar, në rastet se ata vërejnë një parregullsi, mënyrat dhe mjetet që ata duhen të përdorin për ti denoncuar në çdo rast.

• Mjetet e komunikimit



Media sociale. (Do të postohen në këto rrjete mesazhe informuese dhe sensibilizuese me tekst, video, audio, etj mbi parandalimin e veprave penale në fushën e zgjedhjeve.)



Takime me zgjedhësit (Do të zhvillohen takime me target grupet e synuara të cilët do të informohen mbi mënyrën e denoncimeve, në rastet që ata ndeshen me një parregullsi në të gjithë procesin e zgjedhjeve)



App KQZ (Nëpërmjet aplikacionit mund të gjendet sesioni "denonco" ku cilido mund të denoncojë shkeljet e ndryshme zgjedhore.)



Web KQZ (Në website e KQZ do të publikohet i gjithë informacioni mbi mekanizmat e denoncimeve.)



Spote Televizive (Do të transmetohet spot televiziv në televizionet kombëtare dhe lokale mbi listën e zgjedhësve dhe se për çdo pasaktësi që mund të ndeshin, ku do të drejtohen për ti rregulluar ato, në gjuhën e shenjave, për personat që nuk flasin dhe nuk dëgjojnë).

- **Periudha e zhvillimit të kësaj fushate:** Janar 2025 deri ditën e zgjedhjeve



KQZShqiperi



KQZShqiperi



KQZShqiperi



KQZShqiperi



KQZShqiperi



kqz.gov.al



4 Informimi i personave me vështirësi në shikim dhe sigurimi i burimeve edukative në formate të ndryshme për të adresuar nevojat e tyre specifike.

- **Grupi ku adresohet:** Zgjedhësit me aftësi të kufizuar në shikim.

Ky objektivi ka për qëllim të informojë zgjedhësit me vështirësi në shikim mbi hapat që ata duhen të ndjekin që nga koha kur del lista paraprake e zgjedhësve deri në ditën e votimit, si të informohen për listën e zgjedhësve dhe qendrën e tyre të votimit. Nëse zgjedhësit kanë pasaktësi në listë, të emrit apo vendbanimit, i jepet gjithë informacioni me hapat që ata duhet të ndjekin për ti ndryshuar. Gjithashtu informohen se ku duhet të drejtohen si dhe mjetet e ndryshme të komunikimit, ku ata mund të gjejnë gjithë informacionin mbi procesin zgjedhor dhe si ata mund të votojnë me anë të shabllonit.

• Mjetet e komunikimit



Media sociale (Do të postohen në këto rrjete mesazhe informuese dhe sensibilizuese me audio, etj mbi hapat të ndryshëm të procesit zgjedhor.)



Takime me zgjedhësit (Do të zhvillohen takime me këtë target grup të cilët do të informohen se ku mund të gjejnë emrin e tyre në listën e zgjedhësve dhe qendrën e votimit, ku gjithashtu do të nisët materiali dhe në organizatat që mbrojnë interesat e personave me aftësi të kufizuar me qëllim shpërndarjen e informacionit edhe nëorganizatat e tjera të rrjete në qytete të ndryshme të vendit.)



App KQZ (Nëpërmjet aplikacionit mund të marrin informacionin bazë të edukimit të zgjedhësve të përshtatur (të aksesueshëm) për personat që nuk shikojnë.)



Spote radiofonike (Do të transmetohet spot mbi listën e zgjedhësve, për cdo pasaktësi që mund të ndeshin dhe se ku do të drejtohen për ti rregulluar ato në radiot më të ndjekura.)



Shablloni (Në çdo qendër votimi do të jenë shabllonët që ti vijnë në ndihmë për të votuar zgjedhësve që nuk shikojnë)



KQZShqiperi



KQZShqiperi



KQZShqiperi



KQZShqiperi



KQZShqiperi



kqz.gov.al

5 Informimi i zgjedhësve që nuk flasin, duke përshtatur fushatën e edukimit dhe informimit në gjuhën e shenjave.

- **Grupi ku adresohet:** Zgjedhësit me aftësi të kufizuar (zgjedhësit që nuk flasin dhe nuk dëgjojnë)

Ky objektivi ka për qëllim të informojë zgjedhësit që nuk dëgjojnë dhe të rrisë mundësitë e tyre për të marrë informacionin zgjedhor në mënyrë të pavarur.

Informacioni mbi hapat që ata duhen të ndjekin që nga koha kur del lista paraprake e zgjedhësve deri në ditën e votimit, si të informohen për listën e zgjedhësve dhe qendrën e tyre të votimit. Nëse zgjedhësit kanë pasaktësi në listë, të emrit apo vendbanimit, i jepet gjithë informacioni me hapat që ata duhet të ndjekin për ti ndryshuar.

• Mjetet e komunikimit



Media sociale (Do të postohen në këto rrjete mesazhe informuese dhe sensibilizuese me audio, etj mbi hapat të ndryshëm të procesit zgjedhor.)



Takime me zgjedhësit që nuk dëgjojnë (Do të zhvillohen takime me këtë target grup dhe me të rinjtë, kryesisht votues për herë të parë, të cilët do të informohen se ku mund të gjejnë emrin e tyre në listën e zgjedhësve dhe qendrën e votimit; hapat e procesit të votimit etj. Do të nisë gjithashtu të shpërndahet informacioni zgjedhor dhe tek organizatat që mbrojnë interesat e personave me aftësi të kufizuar me qëllim shpërndarjen e informacionit edhe tek organizatat e tjera në rrjete në qytete të ndryshme të vendit.)



App KQZ (Njëpërmjet aplikacionit mund të marrin informacionin bazë të edukimit të zgjedhësve të përshtatur (të aksesueshëm) për personat që nuk flasin dhe dëgjojnë.)



Spote televizive (Do të transmetohet spot televiziv në televizionet kombëtare dhe lokale mbi listën e zgjedhësve dhe se për çdo pasaktësi që mund të ndeshin, ku do të drejtohen për ti rregulluar ato, në gjuhën e shenjave, për personat që nuk flasin dhe nuk dëgjojnë).



KQZShqiperi



KQZShqiperi



KQZShqiperi



KQZShqiperi



KQZShqiperi



kqz.gov.al



Edukimi, Informimi dhe
Ndërgjegjësimi i Zgjedhësve
me Aftësi të Kufizuara



2 0 2 4